



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

**Plani i Integruar i Ministrisë
2010**

Janar 2010



Mesazhi i Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme

Edhe përgjatë vitit 2010, Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të Programit të Qeverisë Shqiptare për marrëdhëniet me jashtë, do të jetë tërësisht e angazhuar për përmbushjen e përgjegjësisë së saj në funksion të integritit të plotë të vendit në strukturat euro-atlantike, duke mbështetur por njëkohësisht edhe duke tërhequr vëmendjen, për të angazhuar maksimalisht institucionet e tjera shqiptare, në plotësimin e standardeve integruese të vendit.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Punëve të Jashtme, ngarkohet të ndjekë me prioritet procesin e integritit evropian të vendit.

Anëtarësimi i vendit në NATO, përbën një ngjarje madhore dhe mjaft të rëndësishme në historinë e Shqipërisë, e cilësuar si ngjarja më e rëndësishme pas shpalljes së pavarësisë së vendit. Ministria e Punëve të Jashtme, do të angazhohet intensivisht për një pjesëmarrje aktive dhe përfaqësim dinjitoz në të gjitha strukturat e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Në përputhje me Programin e Qeverisë së Integritit Evropian, Ministria e Punëve të Jashtme do të ketë si shtyllë kryesore të punës së saj, angazhimin tërësor për përshpejtimin e këtij procesi deri në finalizimin me sukses të tij. Në këtë kuadër, Ministria e Punëve të Jashtme do të ndjekë me prioritet hapat e fundit të procesit të liberalizimit të vizave me BE-në, etapat drejt marrjes së statusit kandidat dhe monitorimin e zbatimit me rigorozitet të detyrimeve të raportit të përparimit të Bashkimit Evropian, sipas detyrimeve të përcaktuara në MSA.

Republika e Kosovës, vazhdon konsolidimin e gjithanshëm paralelisht me procesin e njohjes ndërkombëtare, për të cilin Ministria e Punëve të Jashtme, është angazhuar intensivisht. Ky proces deri tani, ka ecur me ritme të kënaqshme përkundrejt kundërshtimeve të disa vendeve dhe efektit që ato gjenerojnë në hapësirën e tyre të ndikimit. Ekzaktësisht janë 65 vende nga të gjitha kontinentet, që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës deri më sot. Ministria e Punëve të Jashtme, do t'i ushtrojë maksimalisht përgjegjësitë e saj dhe do të vazhdojë të përdorë të gjitha mjetet që ka në dispozicion, në planin dypalësh dhe shumëpalësh, për të ndikuar në rritjen e vazhdueshme të numrit të vendeve që e njohin Republikën e Kosovës në të ardhmen. Avancimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit pa asnjë përjashtim, do të vazhdojë të ketë të njëjtin kujdes si kontribut konkret në forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Në përputhje me orientimet e Qeverisë, Ministria e Punëve të Jashtme do të vijojë ta vërë diplomacinë në shërbim të ekonomisë, burimeve dhe potencialeve të vendit, duke synuar tërheqjen e investimeve të huaja, paraqitjen reale dhe të përditësuar të mundësive ekonomike dhe turistike që ofron Shqipëria, si dhe duke bërë të njohura ndërkombëtarisht vlerat e pasura kulturore që mbart vendi. Duke siguruar një prani më të mirë të vendit në organizatat ndërkombëtare, në nismat shumëpalëshe dhe

aksionin ndërkombëtar në tërësi, Ministria e Punëve të Jashtme kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e rolit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, mundëson prezantimin më të mirë e më të gjerë të vendit dhe imazhit të tij në botë. Për këtë qëllim, duke vijuar procesin e zgjerimit diplomatik, përveç hapjes së dy përfaqësive të reja (Sllovakia, Bosnjë-Hercegovinë), Ministria e Punëve të Jashtme do të vijojë me procesin e hapjes së qendrave kulturore në metropolet e mëdha.

Kriza ekonomiko-financiare e viteve të fundit dhe pasojat e përbotshme të saj, janë tregues të një bote gjithnjë e më të ndërvarur dhe që po përballlet me sfida të reja e me të papritura, që kërkojnë adaptimin e politikave dhe të strukturave përkatëse edhe në Shërbimin e Jashtëm. Kontributi i Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, do të vazhdojë të jetë një vlerë e shtuar në përpjekjet e përbashkëta për stabilitet, paqe, siguri dhe mirëqenie në botë, duke iu përmbajtur angazhimit për ta bërë Shqipërinë aktor edhe më të rëndësishëm si në planin rajonal, ashtu edhe në atë evropian e më gjerë.

Ilir META

Zv/Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	5
2	Dokumente strategjike të Ministrisë.....	7
3	Programet buxhetore të Ministrisë	9
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2009	11
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	16
Aneks 1	Rezultate që lidhen me Integrimin Europia.....	19
Aneks 2	Projekt-ligjet për tu paraqitur.....	21
Aneks 3	Investimet publike	37
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	40
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	41

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Punëve të Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të Programit të Qeverisë. Ministria e Punëve të Jashtme, në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson dhe mbron interesat kombëtare, si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë, synon rritjen e rolit të Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare dhe ato Rajonale, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në aktet ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të Programit të Qeverisë së Integritit Evropian, ka për mision parësor të saj, realizimin e prioriteteve në fushën e marrëdhënieve me jashtë, që në esencë synojnë:

- Forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me vendet e Bashkimit Evropian dhe strukturat evropiane, në kuadër të procesit të Integritit të vendit në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, Ministria e Punëve të Jashtme, synon përfundimin e procesit të liberalizimit të vizave me BE-në brenda vitit 2010, marrjen e statusit kandidat dhe rritjen e cilësisë së marrëdhënies Shqipëri-BE, edhe në dritën e ndryshimeve të reja strukturore që sjell hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës;
- Forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe me vendet e rajonit, me partnerët strategjikë e ata kryesorë, në përputhje dhe në mbështetje të interesave të vendit dhe të shtetasve të saj;
- Forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dy e shumëpalëshe me të gjitha vendet e botës, duke u fokusuar tek partnerët strategjikë dhe shtetet me ekonomi të zhvilluar apo që kanë një peshë të rëndësishme politike në arenën globale, me synimin kryesor të mbështetjes të interesave të vendit dhe shtetasve të saj;
- Ndihmë të gjithanshme autoriteteve dhe strukturave të Republikës së Kosovës në procesin e njohjes ndërkombëtare të saj, në forcimin e institucioneve dhe zhvillimin e gjithanshëm të shtetit të ri, duke vendosur një partneritet të ngushtë, të përfshirë në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dy e shumëpalësh rajonal;
- Mbështetja e zhvillimeve gjithëpërfshirëse rajonale që kanë për qëllim sigurinë, paqen dhe qetësinë në rajon, mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit duke konsoliduar dhe thelluar më tej marrëdhëniet diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit;
- Vënien e diplomacisë në shërbim të ekonomisë dhe burimeve të vendit, duke synuar thithjen e investimeve të huaja dhe reklamim më të madh të mundësive ekonomike e turistike që ofron Shqipëria, bërjen të njohura ndërkombëtarisht të vlerave dhe

pasurive kulturore kombëtare, sikundër dhe përdorimin sa më efikas të diplomacisë publike si një mjet për të tërhequr vëmendjen e publikut ndërkombëtar,

- Mbrojtjen e të drejtave të interesave të vendit dhe të shtetasve të saj jashtë vendit;

- Forcimin e mëtejshëm të strukturave të Shërbimit të Jashtëm, zgjerimin dhe forcimin e pranisë diplomatike të vendit, ngritje në një nivel më të lartë të marrëdhënieve midis shteteve si bazë për zhvillimet në fusha të ndryshme me interes të përbashkët dhe interes të përgjithshëm;

- Rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, nismat shumëpalëshe dhe koalicionet ndërkombëtare, duke synuar avancimin e rolit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, ngritjen e imazhit të vendit tonë në botë, përfshirjen në projekte shumëpalëshe që kanë për qëllim stabilitetin, paqen, sigurinë dhe mirëqenien në botë.

2 Dokumente strategjike të Ministrisë

Strategjia Sektoriale e Marrëdhënieve me Jashtë

Qëllimet

Politika e jashtme e Republikës së Shqipërisë, është gjithnjë në shërbim të mbrojtjes dhe nxitjes së interesave të shtetit dhe të shtetasve të saj dhe në këtë kuadër, është tërësisht në mbështetje të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Veprimtaria diplomatike shqiptare mbështet, pasqyron dhe promovon reformat e gjithanshme të Qeverisë Shqiptare për plotësimin e standardeve për integrimin evropian të vendit.

Duke i shërbyer qëllimit të integrimit evropian, politika e jashtme shqiptare ka si prioritet zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe, në nivel komunitar me vendet e Bashkimit Evropian, si dhe bashkëpunimin rajonal, dy dhe shumëpalësh. Në këtë kuadër, është mbështetur krijimi i zonës rajonale të tregtisë së lirë; është marrë pjesë aktive në përgatitjen dhe mbështetjen e politikave të zhvillimit në rajon; është mbështetur lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme e korrupsionit; janë ndjekur dhe përkrahur zhvillimet politike dhe ekonomike në vendet e rajonit që synojnë sigurinë dhe zhvillimin rajonal; është arritur vendosja e regjimit të lëvizjes së lirë me shumicën e vendeve të rajonit, ndërkohë që jemi në hapat e fundit të liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian dhe po punohet më tej në liberalizimin e politikave dhe praktikave konsullore. Të gjitha këto dimensione do të forcohen dhe zgjerohen më tej, duke u konkretizuar në të ardhmen e afërt.

Pas anëtarësimit të vendit në NATO, prioritet mbetet realizimi i detyrimeve të Shqipërisë si vend anëtar i Aleancës së Atlantikut të Veriut, bazuar në dokumentet bazë dhe detyrimet themelore në mbrojtje të interesave kombëtare. Përbushja e këtyre detyrimeve, realizon objektivat e sigurisë kombëtare dhe rajonale, si dhe përbën një bazë dhe stimul të fuqishëm për përfundimin e shpejtë të proceseve të vazhdueshme politike, ekonomike dhe ushtarake, që Shqipëria ka ndërmarrë. Në këtë kontekst, integrimi i plotë i vendit në NATO, si një proces përshtatjeje dhe adaptimi me këtë strukturë, i shërben zhvillimit afatgjatë të sigurisë, konsolidimit të vlerave demokratike brenda vendit, rritjes së rolit dhe autoritetit të vendit si dhe zgjerimit të pranisë së vazhdueshme të Shqipërisë në rajon dhe më gjerë.

Përparësi të padiskutueshme në rolin aktiv të Shqipërisë në rajon, do të ketë angazhimi i vazhdueshëm energjik në favor të njohjes sa më të gjerë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në funksion të ruajtjes dhe forcimit të stabilitetit në rajon, zhvillimit të harmonizuar të Kosovës dhe arritjes së standardeve demokratike.

Rritja e vazhdueshme e rolit dhe e pjesëmarrjes së vendit në aktivitete dhe veprimtari ndërkombëtare, dy dhe shumëpalëshe, me vende apo organizata ndërkombëtare, është një synim i përhershëm i politikës së jashtme shqiptare, i cili ka ardhur duke u zgjeruar në përputhje me shkallën e zhvillimit të vendit. Në këtë mënyrë, aktiviteti diplomatik ndikon në zgjerimin e njohjes së vendit, përmirësimin të vazhdueshëm të imazhit të realitetit shqiptar me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e mundësive për investime, si dhe në ndërtimin e marrëdhënieve më të ngushta me vendet e tjera, në një hapësirë gjithnjë e më të madhe. Në mënyrë të veçantë, orientimi i aktivitetit diplomatik në favorizimin e eksporteve shqiptare jashtë dhe investimeve të huaja në vend, do të jetë një tjetër prioritet i diplomacisë ekonomike përgjatë vitit 2010.

Gjithashtu, kujdes i veçantë do t'i kushtohet reformimit të sistemit të Shërbimit të Jashtëm si dhe përmirësimin të shërbimit me publikun të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

3 Programet buxhetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi synon një menaxhim eficient dhe një monitorim efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare të institucionit, mbështetje financiare dhe administrative për realizimin e politikave në tërësi të drejtorive të Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke siguruar një lidhje efikase ekonomike ndërmjet drejtorive e rrjetit të përfaqësive diplomatike shqiptare kudo ndodhen ato.

3.2 PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI KONSULLOR

Politika e këtij programi synon përfaqësimin sa më dinjitoz të Shqipërisë në botë, përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të cilësisë së punës si dhe efikasitetit dhe aktivitetit të përfaqësive diplomatike shqiptare jashtë vendit. Shërbimi konsullor, si pjesë e qenësishme dhe e rëndësishme e aktivitetit me jashtë por njëkohësisht edhe si një shërbim publik, duhet të vazhdojë të reformohet gjerësisht në formë dhe në përmbajtje, për arritjen e nivelit të duhur, me qëllim që të jetë i aftë të përballojë me sukses përgjegjësitë e tij. Bazë e mëtejshme e reformave, do të jetë përdorimi sa më i gjerë i teknologjive të reja të informacionit, në mënyrë të veçantë nëpërmjet informatizimit të shkëmbimit të informacionit dhe shërbimeve që i ofrohen publikut, duke i dhënë kështu shërbimit konsullor mjetet e nevojshme të punës, si dhe duke i siguruar ritmin e përshtatshëm dhe një imazh bashkëkohor. Programi do të udhëhiqet dhe koordinohet në të gjitha fazat e zbatimit të tij nga detyrimet dhe aktivitetet e PZMSA, duke pasur parasysh se reformat për integrimin e vendit prekin gjerësisht shërbimin konsullor si të tillë.

3.3 INTEGRIMI EVROPIAN, PËRFAQËSIMI I SHQIPËRISË NË NATO DHE PROMOVIM I MARRËDHËNIEVE DY DHE SHUMËPALËSHE

Në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, politika e këtij programi synon përfaqësimin sa më dinjitoz të vendit në Organizatën e Atlantikut të Veriut, dhënien e kontributeve përkatëse si dhe marrjen e përgjegjësisë të plota dhe përmbushjen e procesit të integritetit të plotë si vend anëtar i saj.

Programi synon vijimësinë e suksesshme dhe konkrete në Procesin e Stabilizimit Asocimit për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në cilësinë e re të krijuar në marrëdhëniet me BE-në, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit dhe paraqitjes së kërkesës për anëtarësim në BE.

Gjithashtu synohet zgjerimi i marrëdhënieve dypalëshe të vendit tonë me vendet e tjera, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit politik dhe ekonomik. Në këtë kuadër, synohet të realizohet një zgjerim i përfaqësimit të vendit tonë në vende të tjera, me të cilat kemi veçanërisht interesa ekonomike.

Në kuadër të bashkëpunimit shumëpalësh, programi synon forcimin e bashkëpunimit të Shqipërisë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), pjesëmarrje aktive në veprimtaritë e OKB në fushën e sigurisë dhe paqes, çarmatimit, ekonomiko-sociale, të së drejtës ndërkombëtare si dhe të drejtave të njeriut. Prioritet mbetet ndjekja në vazhdimësi e angazhimeve të Qeverisë Shqiptare në kuadrin e dokumenteve të miratuara nga konferencat dhe veprimtaritë e tjera ndërkombëtare, si dhe raportimi i vendit tonë lidhur me zbatimin e dokumenteve, rezolutave dhe konventave të OKB-së. Anëtarësimi i vendit në strukturat e ndryshme të OKB-së dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe ndjekja në vijimësi e aktivitetit të OKB-së në lidhje me Kosovën, përgatitja për zhvillimet e pritshme që lidhen me të si dhe ato që rrjedhin nga njohja ndërkombëtare e Kosovës, do të jenë në fokus të këtij programi.

3.4 PROMOVIMI I IMAZHIT DHE VLERAVE TË VENDIT

Programi synon të përmirësojë imazhin e vendit dhe të shoqërisë shqiptare në tërësi, nëpërmjet promovimit kryesisht jashtë vendit të kulturës, vlerave dhe traditës së pasur shqiptare, rrënjëve të saj të hershme e të pashkëputura evropiane, prezantimit të mundësive për investim e fitim në Shqipëri, burimeve natyrore dhe turistike, lehtësive të krijuara posaçërisht për thithjen e investimeve të huaja direkte në vend dhe klimës tërheqëse e favorizuese për biznesin e huaj, stabilitetin politik, gjendjen e shëndoshë makroekonomike të vendit etj. Programi synon gjithashtu të bëjë sa më të njohur jashtë vendit, strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit dhe mundësive reale që ofron Shqipëria në këtë sektor, si një prej potencialeve të mëdha të zhvillimit të vendit në të ardhmen.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në vitin 2010

Sipas programeve përkatëse, Ministria e Punëve të Jashtme, do të ofrojë produktet e mëposhtme, përgjatë vitit 2010.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës:

- Menaxhim i burimeve njerëzore dhe përzgjedhja e stafit të kualifikuar diplomatik, në përputhje me gradat diplomatike.
- Menaxhim i burimeve financiare nëpërmjet përdorimit efektiv të vlerave materiale dhe monetare.
- Përmirësim i shërbimit të protokollit të shtetit.
- Përmirësimi i kushteve të punës për personelin.

Produktet që do të ofrohen:

- Përzgjedhja e kualifikuar dhe trajnimi i personelit nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimit të vazhdueshëm të diplomatëve.
- Realizimi i Auditit në të gjithë rrjetin e përfaqësive diplomatike shqiptare në botë.
- Automjete të blera për nevoja të punës në përfaqësi dhe Minsitri.
- Ambiente pune të përmirësuara.

4.2 PËRFAQËSITE DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI KONSULLOR

Objektivat e politikës:

- Përmbushja e detyrave që dalin nga PKZMSA dhe SKM.
- Modernizimi i shërbimit konsullor, për të arritur nivele bashkëkohore në shkëmbimin e informacioneve si dhe për të përmirësuar standardet në shërbimet e ofruara.
- Thellimi i marrëdhënieve konsullore me partnerët e huaj dhe shtimi i numrit të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëdhënie konsullore.

Produktet që do të ofrohen:

- Zgjerimi i veprimtarisë së rrjetit konsullor të përfaqësimit duke shtuar takime dhe konsultimet konsullore me 30%.
- Trajnimi konsullor i diplomatëve dhe funksionarëve.
- Përmirësimi i kushteve të ambienteve ekzistuese të pritjes në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësi.
- Përmirësimi dhe zgjerimi i informacionit, në përmbajtje, formë dhe mjete, mbi shërbimet që ofrohen dhe mënyrat se si mund të përfitohen ato (Në këtë kuadër, shënohet përfundimi dhe shpërndarja e Manualit Konsullor).
- Shtimi i stafit konsullor me qëllim përballimin sa më të mirë të detyrave të reja.
- Vendosja e një linje telefonike direkte, me qëllim rritjen e komunikimit mes publikut me shërbimit konsullor.
- Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të Konsujve të Nderit për mbulimin e plotë gjeografik në vendet ku mungojnë përfaqësitë tona diplomatike-konsullore.
- Vënia në punë e sistemit e-visa, integrimi i tij me regjistrin e të huajve.

4.3 INTEGRIMI EVROPIAN, PËRFAQËSIMI I SHQIPËRISË NË NATO DHE PROMOVIM I MARRËDHËNIEVE DY DHE SHUMËPALËSHE

Objektivat e politikës:

- Dhënia e kontributeve përkatëse dhe plotësimi i detyrimeve si vend anëtar i NATO-s.
- Përshpejtimi i procesit të integrimit në BE dhe krijimi i kapaciteteve të nevojshme, për përmbushjen e plotë të detyrimeve në kuadër të Politikës së përbashkët të jashtme dhe sigurisë, si dhe i politikës së përbashkët të mbrojtjes (CFSP, CSDP).
- Zhvillimi i dialogut politik me BE.
- Liberalizimi i vizave me BE-në.
- Marrja e statusit të kandidatit.
- Njohja e Republikës së Kosovës me synimin e arritjes së numrit të nevojshëm për anëtarësimin e saj në OKB-së.
- Kontributi për forcimin e rolit të faktorit shqiptar në Rajon dhe zhvillimi i marrëdhënieve dypalëshe rajonale në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit afatgjatë.
- Forcimi i marrëdhënieve me partnerët strategjikë dhe zhvillimi i marrëdhënieve dypalëshe me të gjitha vendet e botës.
- Pjesëmarrje aktive në organizatat ndërkombëtare dhe forume shumëpalëshe.

Produktet që do të ofrohen

- Përfaqësim dinjitoz i Shqipërisë në të gjitha strukturat dhe aktivitetet e organizuara në kuadër të NATO-s.
- Reagim në kohë dhe cilësi për çështjet CFSP, CSDP.
- Zhvillimi i Këshillit të Stabilizim Asociimit.
- Marrja e statusit kandidat brenda vitit 2010.
- Marrja e vendimit për liberalizimin e vizave brenda vitit 2010.

- Rritja e numrit të vendeve që njohin Republikën e Kosovës.
- Konsolidimi i një bashkëpunimi konkret dhe substancial dy dhe shumëpalësh, veçanërisht në kontekstin Rajonal dhe në marrëdhënie me partnerët strategjikë të Shqipërisë.
- Përfaqësim dinjitoz në organizatat ndërkombëtare dhe forume shumëpalëshe.

4.4 PROMOVIM I IMAZHIT DHE VLERAVE TË VENDIT

Objektivat e politikës:

- Zhvillimi i diplomacisë ekonomike në funksion të tërheqjes së investimeve të huaja në vend.
- Zhvillimi i diplomacisë publike dhe kulturore nëpërmjet afirmimit të identitetit tonë kombëtar evropian dhe vlerave më të mira kombëtare në botë.
- Realizim i politikave kombëtare për zhvillimin dhe mbështetjen e diasporës shqiptare në botë.

Produktet që do të ofrohen:

- Nënshkrime protokollesh bilaterale të bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor.
- Aktivitete promovuese për ekonominë, turizmin, kulturën dhe diasporën shqiptare.
- Blerje dhe shpërndarje materialesh promovuese në të gjitha përfaqësitë shqiptare.

Buxheti

2	Financim i Huaj											0
3	Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
4	Mbulimi i TVSH, Detyrimeve Doganore											0
5	Shpenzime nga te Ardhat											0
2	Perfaqesite diplomatike dhe konsullore	0	44.000	1.273.000	0	0	140.000	0	0	84.000	0	1.541.000
1	Çelje nga Buxheti i Pergjithshem	44.000	1.273.000			140.000				84.000		1.541.000
2	Financim i Huaj											0
3	Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
4	Mbulimi i TVSH, Detyrimeve Doganore											0
5	Shpenzime nga te Ardhat											0
3	Promivimi I imazhit dhe vlerave te vendit	78.000	9.000	35.000	0	0	0	0	0	1.000	0	123.000
1	Çelje nga Buxheti i Pergjithshem	78.000	9.000	35.000						1.000		123.000
2	Financim i Huaj											0
3	Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
4	Mbulimi i TVSH, Detyrimeve Doganore											0
5	Shpenzime nga te Ardhat											0
4	Integrimi europian dhe euroatlantik	53.000	4.000	70.000	0	0	0	0	0	2.000	0	129.000
1	Çelje nga Buxheti i Pergjithshem	53.000	4.000	70.000						2.000		129.000
2	Financim i Huaj											0
3	Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
4	Mbulimi i TVSH, Detyrimeve Doganore											0
5	Shpenzime nga te Ardhat											0
5	Bashkepunimi shumepalesh				0	0	0	0	0		0	0
1	Çelje nga Buxheti i Pergjithshem											0
2	Financim i Huaj											0
3	Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
4	Mbulimi i TVSH, Detyrimeve Doganore											0
5	Shpenzime nga te Ardhat											0

Drejtori i Drejtorise Ekonomike/Finances	Emri	
	Firma	
	Data	

Ko or di	Emri	
	Firma	
	Data	

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Nr.	<u>Treguesit</u>	<u>Njësia</u>	<u>Qëllimi</u>
1	Përfaqësim dinjitoz i Shqipërisë në të gjitha strukturat dhe aktivitetet e Aleancës së Atlantikut të Veriut	53	Pjesëmarrje aktive në të gjitha aktivitetet, seminarët dhe konferencat e organizuara në kuadër të Aleancës.
2	Marrja e vendimit për Liberalizimin e vizave	6 20	Paraqitja e raporteve me shkrim dhe zhvillimi i misionëve faktmbledhëse në terren. Lobim për liberalizimin e vizave me vendet anëtare.
3	Marrja e statusit të kandidatit	25 8 100	Dorëzimi i Pyetësorit Zhvillimi me sukses i misionëve faktmbledhëse Lobim për marrjen e statusit të vendit kandidat
4	Zhvillimi i dialogut politik Shqipëri-BE	2	Zhvillimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit
5	Njohja e Republikës së Kosovës	10	Zhvillimi takimeve dhe vizitave në të gjitha nivelet në vendet anëtare të OKB-së që nuk e kanë njohur ende Republikën e Kosovës me synim shtimin e numrit dhe anëtarësim në OKB.

6	Nënshkrim protokolle bashkëpunimi ekonomik e kulturor	3	Nënshkrim i protokolleve dypalëshe te bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor.
7	Blerje dhe shpërndarje materialesh promovuese	10	Albumë për promovimin e vendit, materiale për diasporën shqiptare në botë si libra shkollorë dhe letrar, abetare, fletore pune etj.
8	Kongrese dhe konferenca	1	Organizimi i Kongresit të Diasporës Shqiptare
9	Aktivitete promovimi në vendet e tjera	3	Aktivitete promovuese në vende te ndryshme
10	Numri i përfaqësive të reja diplomatike të hapura	7	Slllovakia, Estoni, Norvegji, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katar, Kuvajti, Bosnjë e Hercegovinë
11	Vënia në punë e sistemit e-visa, integrimi i tij me regjistrin e të huajve	1	Përmirësimi i sistemit të dhënies së vizave dhe përafrimi i tij me sistemin Shengen
12	Për rritjen e komunikimit të publikut me shërbimin konsullor vendosja e një linje direkte telefonike	1	Përballimi i situatave të veçanta e që kërkojnë veprime të menjëhershme në ndihmë të qytetarëve shqiptarë jashtë vendit

13	Përfundimi dhe shpërndarja e manualit konsullor	1	Manuali Konsullor
----	---	---	-------------------

Aneks 1 Aktivitete

- Pjesëmarrje në mënyrë aktive në të gjitha strukturat e Aleancës së Atlantikut të Veriut (konferenca, seminare);
- Pagesa e kontributeve përkatëse në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO;
- Zhvillimi i dialogut për liberalizimin e vizave me BE;
- Përgatitja e raporteve të përditësuara lidhur me zbatimin e detyrimeve për liberalizimin e vizave;
- Zhvillimi i misioneve faktmbledhëse në Tiranë;
- Zhvillimi i takimeve dhe vizitave të një grupi ekspertësh të MPJ-së me qëllim lobimin për liberalizimin e vizave;
- Zhvillimi i vizitave zyrtare të Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, me qëllim lobimin për liberalizimin dhe marrjen e statusit të kandidatit;
- Zhvillimi i konferencave të përbashkëta me OJF, me qëllim sensibilizimi e opinionit publik për liberalizimin e vizave me BE;
- Zhvillimi i Këshillit të Stabilizim Asociimit;
- Pjesëmarrje në aktivitete shumëpalëshe
- Presidenca e Takimit të 10 të shteteve pale të Konventës për Ndalimin e Minave Antipersonel
- Rritja e numrit të vendeve që njohin Republikën e Kosovës;
- Konsolidimi i një bashkëpunimi konkret dhe substancial dy dhe shumëpalësh, veçanërisht në kontekstin rajonal dhe në marrëdhënie me partnerët strategjikë të Shqipërisë;

- Përfaqësim dinjitoz në organizatat ndërkombëtare dhe forume shumëpalëshe;
- Zgjerimi i rrjetit të përfaqësive diplomatike në hapësirën evropiane dhe në zonat me potencial të rëndësishëm ekonomik.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor kontraktual me vende të ndryshme, duke pasur përparësi veçanërisht me vendet e BE-së;
- Krijimi i hapësirës së lëvizjes së lirë në rajon;
- Heqja detyrimit për viza për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga origjina, që kanë një vizë Shengen;
- Zgjerimi i veprimtarisë së rrjetit konsullor të përfaqësimit duke shtuar takime dhe konsultime konsullore me 30%;
- Trajnimi konsullor i diplomatëve dhe funksionarëve;
- Përmirësimi i normativave konsullore me synim lehtësimin e shërbimeve konsullore;
- Përmirësimi dhe zgjerimi i informacionit, në përmbajtje, formë dhe mjete, mbi shërbimet që ofrohen dhe mënyrat se si mund të përfitohen ato;
- Riorganizimi i Drejtorisë Konsullore dhe shtimi i stafit për përballimin e detyrave të reja;
- Ngritja e sallës operative pranë Drejtorisë Konsullore për përballimin e situatave emergjente;
- Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të konsujve të nderit për mbulimin e plotë gjeografik në vendet ku mungojnë përfaqësitë tona diplomatike-konsullore;
- Ndërtimi dhe vënia në punë me dy faza i sistemit informativ e-visa, integrimi i tij me regjistrin e të huajve;
- Nënshkrime protokollesh bilaterale të bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor;
- Aktivitete promovuese për ekonominë, turizmin, kulturën dhe diasporën shqiptare;
- Blerje dhe shpërndarje materialesh promovuese në të gjitha përfaqësitë shqiptare.

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2010

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Nr.	PROJEKTAKTE	OBJEKTI DHE QELLIMI I PROJEKTAKTIT	MINISTRI PROPOZUES	AFATI I PARAQITJES NE KESHILLIN E MINISTRAVE	KOMENTE
1	Projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të teknologjive sekrete në fushën e mbrojtjes dhe për të cilat është bërë aplikimi i patentës”, bërë në Paris më 21 shtator 1960;	Bashkëpunimi për dhënien e kontributeve për çështjen e mbrojtjes së teknologjive sekrete në fushën e sigurisë.	Ministri i Mbrojtjes Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori II	
2	Projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e NATO-s mbi komunikimin e informacionit teknik për qëllime të mbrojtjes”, bërë	Bashkëpunimi ndërmjet vendeve anëtare për zhvillimin e kapaciteteve për sigurimin e komunikimit për qëllime të mbrojtjes	Ministri i Mbrojtjes Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori II	

	në Bruksel më 19 tetor 1970;				
3	Projektligji për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin lidhur me informacionin atomik”, së bashku me anekset e saj, bërë në Paris më 18 qershor 1964.	Mbrojtja dhe sigurimi i informacionit në lidhje me materialet dhe dokumentacionet për çështjen atomike.	Ministri i Mbrojtjes Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori II	
4	Projektligji për aderimin në Marrëveshjen ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin lidhur sigurinë e informacionit” bërë në Bruksel, më 6 mars 1997;	Mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar nëpërmjet standardeve dhe procedurave specifike.	Ministri i Mbrojtjes DSIK Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori II	
5.	Projektligji për aderimin në Kartën e NAMSO-s	Synon maksimalizimin e efektiviteti dhe mbështetjes logjistike për vendet anëtare ne NATO	Ministri i Mbrojtjes Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori III	

6	Projektligji për ratifikimin e “Marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.	Ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e forcave të Armatosura	Ministria e Mbrojtjes Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori I-rë	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues
9.	Projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Hagës mbi ligjin e aplikueshëm për detyrimet ushqimore	Unifikimi i detyrimeve të prindërve ndaj fëmijëve, në funksion të mirëqenies së tyre	Ministri i Drejtësisë Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori III	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues
11	Projektligji për aderimin në Konventën e Hagës për marrjen e provave jashtë shtetit në çështje civile dhe tregtare	Përmirësimi i kuadrit ligjor në krijimin e lehtësirave për çështjet civile dhe tregtare	Ministri i Drejtësisë Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori III	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues
12.	Projektligji “Për ratifikimin e Protokollit të pestë shtesë të Marrëveshjes mbi forcën shumëkombëshe të paqes në Evropën Juglindore”	Përmirësimi i mëtejshëm të Marrëveshjes për të arritur nivele më të larta të bashkëpunimit midis Shteteve palë si dhe zgjidhjen dhe rregullimin e pikave për plotësimin e kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit vepron SEEBRIG në operacione paqeruajtëse.	Ministri i Mbrojtjes Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori III	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues

13.	Projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Hagës për njohjen e zbatimit të vendimeve në çështjet e detyrimeve ushqimore”	Krijimi i lehtësirave përsa i perket procedurave në çështjet tregtare dhe civile	Ministri i Drejtësisë Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori III	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues
14.	Projektvendimi për miratimin e marrëveshjes së Grantit IDF ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për rindërtim dhe Zhvillim për projektin IDF për forcimin e Zbatimit të Konventës Aarhus	Zbatimi i Konventës së Aarhus për përmirësimin e kuadrit ligjor që lidhet me politikat mjedisore	Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori II	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues
15	Projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për mbrojtjen e Drurëve Tropikalë,	Mbrojtja e Pyjeve dhe drurëve të rallë	Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Ministri i Punëve të Jashtme	Katërmujori III	Në varësi të dërgimit të dokumentacionit të Ministrit propozues

